



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË AUTORITETI I KONKURRENCES

---

Njoftim për shtyp  
(24.04.2014)

Bazuar në disa shqetësime publike të përcjellë nëpërmjet mediave mbi mungesën e konkurrencës në tregjet, produktet e të cilave janë subjekt i akcizës, Autoriteti i Konkurrencës, në zbatim të nenit 28 të Ligjit 9121 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, ka realizuar një monitorim në tregun e mallrave me akcizës nisur nga ndryshimet e fundit në paketën fizikale dhe ndikimin e barrës fiskalë në mallrat e akcizës.

Qëllimi i monitorimit ishte vlerësimi i shkallës së konkurrencës në tregun e produkteve të akcizës nëpërmjet evidentimit të strukturave të tregjeve përkatëse dhe mënyrën e sjelljes së ndërmarrjeve aktive në treg. Metodologjia është bazuar në studime të ngjashme të tilla si: “Studimet e Tregut që kryen EUROMONITOR në industrinë e pijeve alkolike”, dhe “Studim analize mbi ndryshimet e shkallëve minimale të akcizës në pijet alkolike, Raport për DG TAXATION dhe Bashkimin Doganor”.

Pas përpunimit dhe analizës së të dhënave për treguesit e përqëndrimit në tregjet përkatëse u konstatuan se:

*Tregu i importit të kafesë* është një treg jo i përqëndruar me një Indeksi përqëndrimit HHI 969 në të cilin operojnë 180 ndërmarrje ku 18 prej tyre zotërojnë 84% të tregut.

*Në tregun e pijeve energjike* janë importuar 25 marka ku 9 marka janë me kryesore dhe zene 97 % të tregut. Tregu karakterizohet nga konkurrenca dhe shumëllojshëri çmimesh midis markave. Brenda Markës konkurrenca është e ulët, pasi tregjet janë shumë të përqëndruara ose kanë një importues të vetëm.

*Për tregun e Birrës* oferta për birrë në tregun shqiptar sigurohet nga dy burime: prodhimi vendas dhe importi i markave të njohura në rajon dhe botë respektivisht me 93% dhe 7 % të tregut. Prodhimi vendas i birrës përfaqësohet nga 16 ndërmarrje ku 5 ndërmarrjet kryesore tregtojnë markën e tyre në gjithë territorin e vendit, kurse pjesa tjetër e ndërmarrjeve prodhuese të birrës kanë karakter lokal, pra edhe shitjet e tyre janë të lokalizuara në qytetet prodhuese. Tregu i birrës është mesatarisht i përqëndruar me indeksin HHI më të lartë se niveli 1800.

*Në tregun e verës*, kërkesa për verë plotësohet nga importi dhe prodhimit vendas. Në tregun e prodhimit vendas dhe importit të verës operojnë një numër shumë i madh ndërmarrjesh.

Lidhur me *tregun e pijeve alkoolike* prodhimi vendas mbulon rreth 45% të ofertës në treg për pije alkoolike të cilat janë kryesisht prodhime tradicionale të vendit (konjak, raki, uzo) dhe struktura e tregut është shumë e përqëndruar. Në tregun e pijeve

alkoolike ofrohet një shumëllojshmeri pijesh, markash me cmime dhe cilësi të ndryshme.

Në konkluzion të monitorimit rezultoi se për shkak të karakteristikave të tregjeve dhe konkurrencës ndërmjet dhe brenda markave si dhe mbështetur në të dhënat e administruara lidhur me sjelljen ndaj çmimit nuk ka shenja të kufizimit të konkurrencës në tregjet përkatëse. Raporti i detajuar është potuar në faqen zyrtare të Autoritetit të Konkurrencës.